

Seminaret u zhvilluan në rrethet :

Tiranë, më 22 shkurt 2012

Krujë , më 6 mars 2012

Shkodër, më 15 mars 2012

Tematikat e trajtuara u përqëndruan tek :

- -lidhja e sindikatës së rajoneve me strukturat rajonale të punësimit për evidentimin e problemeve të punësimit dhe puna e tyre e bashkërenduar për këtë qëllim;
- -kualifikimi dhe formimi profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës, si domosdoshmëri për punësimin e anëtarësisë sindikaliste;
- -puna me të rinjtë për vlerësimin profesional dhe për rekrutimin e të rinjve në sindikatë, duke luftuar punën informale, diskriminimin e tyre dhe lufta për punë të denjë e paga të denja.

Konkluzione: Në këto seminare ishte një pjesëmarrje e madhe e të rinjve, anëtarë të Forumit të Rinisë së BSPSH-së, si edhe përfaqësues të Zyrave Rajonale të Punësimit të rajoneve, ku u zhvilluan seminare. Në Tiranë problemet e tregut të punës u panë nën këndvështrimin sindikalist, në Krujë nën një këndvështim të përbashkët të sindikatave dhe zyrave rajonale, diktuar nga bashkëpunimi midis këtyre dy partnerëve sociale, ndërsa në Shkodër nën këndvështrimin e zyrës rajonale të punësimit Shkodër. Nëpërmjet këtij projekti u vu theksi në forcimin e bashkëpunimit të sindikatave me Drejtorinë e Punësimit të rajoneve të Tiranës, të Krujës dhe të Shkodrës, si domosdoshmëri për zbutjen e problemeve të punësimit, veçanërisht për të rinjtë, sepse me gjithë punën e bërë në këtë drejtim vërehen shumë mangësi. U shtrua nevoja për kryerjen e studimeve të përbashkëta për efektivitetin e fondeve të dhëna nga shteti për punësimin dhe aftësimin profesional të punonjësve në përputhje me nevojat aktuale dhe perspektive të tregut të punës. Gjithashtu, nga tre temat e zhvilluara , u evidentuan më mirë problemet, për bashkërendimin më të mirë të punës së strukturave tona rajonale dhe të federatave me punëdhënësit, si dhe me strukturat shtetërore për punësimin, për luftën kundër informalitetit dhe përfshirjen e të rinjve në tregun e punës.

SEMINARE TE FINANCUARA NGA FONDACIONI FRIEDRICH EBERT